

Sfida 23

DHJETOR 2006

Aprovohet ne New York nga Asambleja e Pergjithshme e Kombeve te Bashkuara, Konventa e Kombeve te Bashkuara per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar



Iniciativa nderkombetare Per nje standart me te mire jetese per perdoruesit e karrikeve me rrota

Blerta Çani:
Më shumë biznese duhet të ndjekin shembullin e Vodafone Albania



Qendra per Zhvillimin e Shanseve te Barabarta, nje alternative sherbimesh per problematiken e aftesise se kufizuar ne Rajonin e Shkodres



Debat Qytetar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar

Debatet u zhvilluan ne televizionet lokale; TV Teuta (Durrës), ETV (Elbasan) dhe TV Rozafa (Shkoder).



Në këtë numër

Aprovohet ne New York nga Asambleja e Pergjithshme e Kombeve te Bashkuara, Konventa e Kombeve te Bashkuara per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar

Konventa e Kombeve te Bashkuara per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar u aprovua me 13 Dhjetor 2006, ne New York nga Asambleja e Pergjithshme e Kombeve te Bashkuara.

Faqe 3

Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuar në proceset zgjedhore e politike

Faqe 4

Iniciativa nderkombetare

Per nje standart me te mire jetese per perdoruesit e karrikeve me rrota

Faqe 6

Blerta Çani: Më shumë biznese duhet të ndjekin shembullin e Vodafone Albania

Faqe 8

Ndryshimet e fundit ligjore në fushën e aftësisë të kufizuar

Faqe 11

Debat Qytetar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar

Debatet u zhvilluan ne televizionet lokale; TV Teuta (Durrës), ETV (Elbasan) dhe TV Rozafa (Shkoder).

Faqe 12

Qendra per Zhvillimin e Shanseve te Barabarta, nje alternative sherbimesh per problematiken e aftesise se kufizuar ne Rajonin e Shkodres

Faqe 13

Gjithpërfshirja përtej një ligji

Faqe 16

Si të gatuajmë

Faqe 20



Sfida 23

Revistë e përtremuajshme

Financuar nga:

Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

Swedish Helsinki Committee

for Human Rights

Bashkëpunëtorë:

Bardhylka KOSPIRI

Narbis BALLHYSA

Florida KALEMI

Entila ZYBA

Brikena DEMIRAS

Zela KOKA

Edlira GRABOVA

Shoqata e të verbërve të

Shqipërisë

Design and Layout

Grafika ELZANA

Adresa:

Rr.: "A.Z.Çajupi", (Bogdani),
Pallatet e reja "ENIL", K.3
Tiranë

Tel.: +355 4 269426;

E-mail: adrf@icc.al.eu.org

www.adrf.org.al

www.adrf.org.al

Aprovohet ne New York nga Asambleja e Pergjithshme e Kombeve te Bashkuara, **Konventa e Kombeve te Bashkuara per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar**

Konventa e Kombeve te Bashkuara per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar u aprovua me 13 Dhjetor 2006, ne New York nga Asambleja e Pergjithshme e Kombeve te Bashkuara.



Adoptimi i Konventes perfaqeson nje ngjarje historike per personat me aftesi te kufizuar ne mbare boten.

Konventa eshte e nje rendesie te vecante ne jeten e personave me aftesi te kufizuar per faktin se perfaqeson dokumentin e pare ne te cilin aftesia e kufizuar njihet si çeshtje e te drejtave te njeriut.

Te gjitha njerezit duhet te gezojne te drejtat e tyre themelore. Shpesh ky princip eshte larg nga realiteti qe jetojne çdo dite personat me aftesi te kufizuar.

Ne Shqiperi personat me aftesi te kufizuar perballen me paragjykim dhe diskriminim ne te gjitha sferat e jetes. Eshte hera e pare qe nje instrument nderkombetar i ketij lloji mbulon si te drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore te

njerezve me aftesi te kufizuara, duke vendosur nje kuader efektiv per mbrojtjen e te drejtave te 650 milion e njerezve me aftesi te kufizuara ne bote. **Vendet ratifikuese do te kene detyrimin ligjor ti trajtojne njerezit me aftesi te kufizuara si individ me te drejta te shprehuara qarte ne 50 nenet e konventes, duke mbuluar te gjitha fushat e jetes.**

Forumi European i Aftesise se Kufizuar (EDF) perfaqesues e 50 milione njerezve me aftesi te kufizuara ne nivel European, ka luajtur nje rol udheheqes ne negociatat dhe aprovimin final te konventes. Per me teper, procesi i aprovimit te ketij traktati perben nje lajm ne procedurat e negociimit ne OKB, sepse per here te pare, OJF e aftesise se kufizur nga gjitha bota kane per-

Procesi i firmosjes dhe ratifikimit te Konventes

Ne 30 Mars 2007, Konventa do te jete e hapur per firmosje dhe ratifikim ne 192 vendet anetare te OKB-se. Konventa duhet te ratifikohet nga te pakten 20 vende qe te hyje ne fuqi. Si entite firmoses, vendet do te vlersohen persa i perket zbatimit te te drejtave te personave me aftesi te kufizuara. Per me teper, kjo kerkon marrjen dhe aprovimin e masave dhe legjislacionit te nevojshem per nje mbrojtje sa me efektive te ketyre te drejtave.

Komisioni European do ti paraqese nje propozim Keshillit te Bashkimit European, ne fillim te vitit 2007, me qellim qe te vendose procedura firmosjeje dhe ratifikimi te pranuar nga vendet anetare. Vendimi do te merret unanimisht.

Aftesia e kufizuar, nuk eshte pare e cilesuar si nje çeshtje prioritare deri me sot. Prej momentit te adoptimit, çdo shtet ka rolin legjitim dhe obligimin moral te mbroje te drejtat e personave me aftesi te kufizuar.

berë një forcë shtytëse drejt aprovimit final të tekstit.

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) është përfshirë që në fillimet e levizjes për hartimin e kësaj Konvente. Si anëtarë e EDF (Forumit Europian të Aftësive të Kufizuara) dhe DPI (Organizates

Nderkombetare të Personave me Aftësi të Kufizuara) si dhe si organizate e fokusuar në fushën e të drejtave të njeriut me fokus mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, FSHDPAK ka marrë pjesë në seminare dhe forume Europiane duke dhënë opinione dhe sygjerime konkrete mbi përmbajtjen e draft kon-

ventes. FSHDPAK përmes një procesi të vazhdueshëm avokatie e bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe organizmat të tjerë ka bërë të mundur përfshirjen e qeverisë shqiptare, në procesin hartimit të konventes si dhe me tej shprehjen e gadishmerisë për firmosje dhe ratifikim.

Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuara në proceset zgjedhore e politike

Tashmë me një eksperiencë të fituar në disa fushata ndërgjegjësuese për pjesëmarrjen në votime të zgjedhësve me aftësi të kufizuara, në disa raunde zgjedhore, parlamentare dhe vendore, në kuadrin e projektit “Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuara në proceset zgjedhore e politike”, i mbështetur nga USAID / IRI, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara është përfshirë sërish, së bashku me shoqatat e spektrit të aftësisë së kufizuara, në fushatë ndërgjegjësuese zgjedhore për zgjedhjet vendore 2007. Synimi është që të tërhiqet vëmendja e subjekteve politike, pjesëmarrëse në zgjedhje, ndaj problematikës së aftësisë së kufizuara për ta bërë atë pjesë të programe të tyre si edhe për të mundësuar pjesëmarrjen e sa më shumë zgjedhësve me aftësi të kufizuara në votim të drejtpërdrejtë, të barabartë e të fshehtë. Kjo fushatë do të zhvillohet, e drejtuar nga FSHDPAK, përveç Tiranës



edhe në Shkodër e Librazhd në një periudhë para, gjatë dhe pas zgjedhore.

Në periudhën para zgjedhore, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara organizoi disa takime me ekspertëve të shoqatave të aftësisë së kufizuara, kombëtare dhe lokale, me qëllim hartimin e një Manifesti me problematikën më të mprehtë të aftësisë së kufizuara që t’i paraqitej partive pjesëmarrëse në votime për ta bërë pjesë të platformave të tyre elektorale. Në disa takime rradhazi ekspertët

diskutuan për problemet konkrete që do të përfshiheshin në këtë manifest, formatimin e tij si dhe për domosdoshmërinë e bërjes prezente sa më gjërë të tij.

Drafti i këtij manifesti u prezantua në një konferencë të gjerë për shtyp që u zhvillua në ambientet e Hotel Tirana International, me pjesëmarrjen e shoqatave të të gjithë spektrit të aftësisë së kufizuara përballë përfaqësuesve të disa partive politike, në prezencën e mediave kombëtare e lokale. Përfaqësuesit e partive politike, pjesë-

marrës në këtë konferencë u angazhuan për një vëmendje të veçantë gjatë fushatës zgjedhore ndaj problematikës së aftësisë së kufizuar si dhe për përfshirjen e saj në programet e tyre elektorale.

Fushata ndërgjegjësuere do të vazhdojë me shpërndarjen

më të gjerë të këtij Manifesti si dhe me kontakte direkte me kandidatë të subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje, me monitorimin e procesit të votimit nga vëzhgues me aftësi të kufizuar për të parë se sa akses ofrohet për pjesëmarrjen e zgjedhësve me aftësi të kufizuar në votime.

Në periudhën paszgjedhore do të kontaktohen dhe do të zhvillohen trajnime ndërgjegjësuere të kandidatëve fitues të institucioneve të pushtetit vendor për të realizuar një zbatim sa më të plotë të politikave dhe legjislacionit për aftësinë e kufizuar në nivel vendor.

MANIFEST

I pranuar më 30 nëntor, 2006

Nga Grupimi i Organizatave për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar
Drejtuar:

Kandidatëve për Kryetarë dhe Këshilltarë të Njësive të Pushtetit Vendor

Subjekteve Politike që ata përfaqësojnë në Zgjedhjet Vendore

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe strukturave të tjera për administrimin e zgjedhjeve

Ne, përfaqësuesit e Organizatave në Mbrojtje të të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe të Prindërve të Fëmijëve dhe Personave që nuk përfaqësojnë dot vetveten, që mbrojmë interesat e rreth 100.000 Personave me Aftësi të Kufizuar,

Duke qenë se:

Zgjedhjet Vendore ofrojnë një mundësi për të gjithë të zgjedhurit e ardhshëm që të marrin përsipër angazhime dhe të propozojnë alternativa për të siguruar që Personat me Aftësi të Kufizuar të gëzojnë të drejta të plota politike, ekonomike, qytetare dhe shoqërore;

Personat me Aftësi të Kufizuar përbëjnë rreth 10% të popullsisë dhe të paktën 1 në çdo 4 persona ka një pjesëtar të familjes me aftësi të kufizuar;

Shoqëria shqiptare është ende në një situatë ku qytetarët e saj nuk ndjehen të barabartë sa duhet në të drejtat dhe nevojat e tyre.

Votat tona - të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe familjarëve të tyre (minimalisht 10%) do të orientohen drejt kandidatëve të subjektit që bën pjesë të platformes së tij elektorale KËTË MANIFEST duke ofruar edhe hapësira të lira për kandidatët me aftësi të kufizuar.

Organet e qeverisjes vendore, që ndodhen më pranë gjendjes dhe nevojave të Personave me Aftësi të Kufizuar, mbeten përgjegjësit kryesorë për zbatimin e ligjeve dhe respektimin e të drejtave;

I drejtohem i të gjithë kandidatëve për kryetarë dhe këshilltarë të njësive të pushtetit vendor dhe partive politike që ata përfaqësojnë si edhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe strukturave të tjera për administrimin e zgjedhjeve vendore

Duke kërkuar:

1. Mbështetje për zgjidhje legjislative në nivel qendror
2. Planifikime vendore për zbatimin e Strategjisë Kombëtare

të Personave me Aftësi të Kufizuar

2.1 Realizimin e prioriteteve të Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar:

2.1.1 Identifikim të rasteve dhe vlerësim të nevojave për edukim, punësim dhe shërbime për Personat me Aftësi të Kufizuar në çdo njësi vendore;

2.1.2 Parashikime buxhetore dhe programe për të realizuar:

- Arsim gjithpërfshirës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar

- Rehabilitim dhe punësim për Personat me Aftësi të Kufizuar

- Shërbime shëndetësore dhe sociale për Personat me Aftësi të Kufizuar

- Përshtatshmëri mjedisore dhe mjeteshe

3. Respektim të plotë dhe të barabartë të të drejtës së zgjedhjes për Personat me Aftësi të Kufizuar.

Iniciativa nderkombetare

Per nje standart me te mire jetese per perdoruesit e karrikeve me rrota

Nga data 6-11 nentor 2006, ISPO (Instituti per Studime te Protezava dhe Ortezave,) Suedi, Organizata Boterore e Shendetesise/OBSH, Agjensia Nderkombetare per Zhvillim e Shteteve te Bashkuara te Amerikes/USAID dhe Mobility India, organizuan ne Bangalore, Indi “Konference Konsensuale per karriket me rrota per vendet ne Zhvillim”.

Ne konference moren pjese perfaqesues nga organizata te perfshira ne prodhimin e karrikeve me rrota ne vendet e zhvilluara dhe ne vendet ne zhvillim, universitete nga SHBA, Norvegji te perfshire ne studime, kerkime dhe testimet te standarteve te karrikeve me rrota te nevojshme per t’iu pergjigjur sa me mire nevojave te individit, organizata dhe institucione te fokusuar ne mbrojtjen e te drejtave te personave me aftesi te kufizuara dhe ofrimin e sherbimeve rehabilituese, si dhe organizata te cilat ofronin shperndarjen ne mase te karrikeve me rrota. Ne kete Konference mori pjese dhe nje perfaqesues nga Fondacioni Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuara (FSH-DPAK)

Organizata Boterore e Shendetesise po punon dhe ka pergatitur tashme nje draft te udhezuesit/standarteve te domosdoshme per prodhimin e karrikeve te duhura me rrota per njerezit ne nevoje.

Draft standartet perbene objektin kryesor te diskutimeve ne



kete konference me synim perpunimin dhe plotesimin e tyre me informacionin dhe rekomandimet e nevojshme .

Nje diskutim i gjere, intensiv per 6 dite me rradhe perfshiu prezantime, pune ne grupe, çeshtje te shtruar per debat, shkembim te eksperincave dhe ofrim te ekspertizes nga gjithe vendet e botes me perfshirjen e gjithe grupeve te interesit.

Diskutimet gjate diteve te konferences ofruan kontribut ne pasurimin dhe permiresimin e metejshem te draft standarteve. Ndryshimet e sygjeruara perfshijne elemente si perkufizimi i

karrikes me rrota, me tej perkufizimi mbi karriken e duhur me rrota, perfshirja e perdoruesit, percaktimi i standarteve etj. Sipas OBSH, perkufizimi i karrikes me rrota eshte “Nje mjet levizes qe promovon zhvillim dhe pjesmarrje”(OBSH). Ndersa perkufizimi i asaj qe konsiderohet “Karrikja e duhur me rrota” ne baze dhe te diskutimeve gjate diteve te konferences komnkludoi ne “ **Nje karrike me rrota konsiderohet si e duhur kur ajo ploteson nevojat individuale ne perputhje me kushtet e ambjentit, eshte ne permasat e duhura dhe ofron mbeshteteje**

per trupin mbi baze te parimeve biomekanike, eshte e sigurte dhe e qendrueshme, gjendet dhe eshte e arritshme, mund te mirembahet dhe eshte aktiviteti i qendrueshem ne nje vend, kundrejt nje çmimi sa me ekonomik dhe te perbalueshem.”

Ajo qe bie ne sy ne kete perkufizim eshte fakti qe ne qender eshte individi, pra cka eshte e rendesishme eshte cilesia e jetes se individit, dhe jo thjesht pajisja me karrike me rrota.

U diskutuan gjithashtu pikat e forta si dhe pikat e dobta te formave te ndryshme te ofrimit te karrikeve me rrota.

Qellimi i Konferences ishte arritja e nje konsensusi per Standardet/udhezuesin per karriket me rrota per vendet me pak te zhvilluara.

Me nje konsensus te pergjithshem u arrit ne konkluzionin se : “ Karriket e importuara kryesisht per spitalet , apo karriket ortopedike nuk jane te pershtatshme per njerezit me aftesi te kufizuara, pasi eshte e domosdoshme qe karrikja te percaktohet dhe te dizenjohet nga profesioniste te fushes ne perputhje me nevojat e individit dhe jo te shperndahen ne mase”.

Argumenta qe mbeshtesin konsensusin e mesiperem, qe konsiston ne mbeshtetejen e prodhimit lokal jane:

- Dizenjimi me i adaptueshem per kushtet lokale
- Ofron mundesi per riparim
- Ofron mundesi per adaptim dhe plotesim te kerkesave specifike nga individi ne nevojte



- Eshte me e fokusuar tek perdoruesi, sepse perdoruesi eshte prezent ne çdo hallke te procesit
- Ofron sherbime multisektoriale, nga ekipe multidisciplinare tek perdoruesit e karrikeve me rrota
- Ofron mundesi per zhvillim ekonomik, (veprimtari ekonomike ne vend)
- Ofron mundesi punesimi duke perfshire dhe punesimin per njerezit me aftesi te kufizuara
- Krijon mundesi dhe kerkon perfshirjen e Qeverise

U theksua domosdoshmeria e stimulimit dhe inkurajimit te prodhimit lokal te karrikeve te pershtatshme, ne kushtet kur ne shume vende tashme jane krijuar dhe konsoliduar praktika pozitive qe jo vetem ofrojne prodhim por edhe riparim si dhe sherbime te tjera mbeshtetese, duke ju pergjigjur nevojave specifike te çdo individi. Prej disa vitesh, programe te sukseshme jane ndertuar ne shume vende te botes, me teknologji, asistence teknike dhe ekspertize nga organizata si Motivimi, Angli, tashme te kon-

soliduara per dizenjimin e karrikeve te duhura me rrota per vendet ne zhvillim.

Ne kete Konference mori pjese dhe Fondacioni Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuara (FSHDPAK), si nje organizate qe tashme prej 10 vitesh zhvillon me sukses projektin “ Sherbime mbeshtetese per njerezit ne nevojte per karrike me rrota ne Shqiperi” . Ky projekt ka filluar ne vitin 1996, kur nje ekip me specialiste Motivim-it, Angli ne bashkepunim me eksperte te Motivimit - Rumani, ne pergjigje te nevojtes per kete sherbim, per nje periuadhe prej 9 muajsh krijuan kapacitete lokale dhe ndertuan kete projekt ne Shqiperi. Ky program, i vetmi i ketij lloji ne Shqiperi, i manaxhuar nga staf lokal, ne perberjen e te cilit ka gjithashtu njerez me aftesi te kufizuara (2 prej te cileve perdorues te karrikeve me rrota) ka prodhuar dhe shperndare mbi 2000 karrike me rrota per njerezit ne nevojte ne Shqiperi. Ky program perben nje model te nje sherbimi social shume dimensional, i cili veç mjetit per levizje, ofron informim, trajnim dhe pervetesim te aftesive per perdorim te karrikes me rrota, si dhe per-

gatitjes për të jetuar në mënyrë të pavaruar. Për të bërë të mundur vazhdimësinë e programit, njëkohësisht dhe krijimin e shanseve për përdoruesit e karrikerave me rrota për përfshirjen në shoqëri, FSHDPAK zhvillon njëkohësisht fushatë të vazhdueshme avokative për krijimin e një ambienti pa barrierë ndërtimore, mundësimin e aksesit në arsim, punësim, përfshirjen në proceset elektorale. Për realizimin e misionit të tij, FSHDPAK punon për krijimin e partneriteteve serioze e të qëndrueshme me aktore të tilla si përfaqësues të Qeverisë në nivel qendror e lokal, përfaqësues të shoqërisë civile përfshirë organizatat e aftësive të kufizuara, OJF të fokusuar në fushën e të drejtave, përfaqësues të biznesit, medianë dhe shkruar dhe atë elektronike. Komuniteti i donatorëve, si Oxfam Britanikë e Madhe, Novib –Oxfam/Hollandë, Vodafone Shqipëri, përmes Vodafone Foundation, Qeveria Shqiptare përmes Institutit të Sigurimeve Shoqërore, dhe së fundmi Agjencia e Ndihtes për Zhvillim Nderkombëtar e SHBA(USAID) kanë qënë jo vetëm finacues por dhe bashkëpunuese që kanë ndihmuar në qëndrueshmërinë, zgjerimin dhe zhvillimin e këtij programi në Shqipëri.

Duke vlerësuar eksperiencën e suksesshme të FSHDPAK, pjesë e programit të Konferencës ishte dhe një prezantim nga kjo organizatë për pjesëmarrësit në një nga seancat plenare. Çdo prezantim përbente objekt për pyetje e diskutime, dhe ajo që u vu re pas prezantimit nga përfaqësuesi i FSHDPAK-se ish-

të vlerësimi për arritjet e kesaj organizate në një vend të vogël si Shqipëria në një periudhë tranzicioni e një situatë jo fort të qëndrueshme politike. Ky prezantim jo thjesht paraqiti programin, arritjet, vështësitë dhe sfidat me të cilat ndeshet FSHDPAK, në mënyrë të veçantë për të siguruar përfshirjen e këtij programi si pjesë të politikave për shërbime sociale të Qeverisë Shqiptare, por në të njëjtën kohë shërbeu si një mundësi për prezantimin e njohjen e Shqipërisë, si një vend me potenciale zhvillimi, në një aktivitet ku pati pjesëmarrje nga e gjithë bota. Kjo mundësi FSHDPAK ju ofrua në kuadrin e mbështetjes që USAID, Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ndihtë dhe Bashkëpunim Nderkombëtar, ofron përmes fondeve të ofruara nga taksapaguesit amerikanë, për zhvillimin e programit të shërbimeve mbështetëse për njëzëritë në nevojë për karrikerave me rrota në Shqipëri.

Për FSHDPAK, pjesëmarrja në një proces kaq të rëndësishëm si hartimi i një manuali me standarde për karrikerat me rrota për vendet në zhvillim nga Organizata Botërore e Shëndetësisë/OBSH, përben një tjetër kontribut që Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ofron në procese të rëndësishme që kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësive të jetës dhe respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri e kudo në botë.

*Florida Kalemi
Koordinatorë Programi prene
FSHDPAK*

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Vodafone Albania në vigjilje të festave të Vitit të Ri, u dhuroi 30 karrige me rrota personave me aftësi të kufizuara nga Tirana, Durrësi, Burreli, Beratit dhe Gjirokastra në një aktivitet të organizuar në 19.12.2007 në ambientet e Hotel Tirana International. Gjithçka ka ardhur në formën e një dhurate prej tyre, si rezultat i projektit mbështetës që Vodafone i ka dhënë punishtes "Mirësia" ku edhe janë prodhuar karriget. Kjo është një nga punishtet e vetme në vend, projekt i FSHDPAK, në të cilën punojnë 5 persona me aftësi të kufizuara. Duke vlerësuar bashkëpunimin prej tre vjetësh me Vodafone Group Foundation, përmes Vodafone Albania, drejtoresha ekzekutive të FSHDPAK, Blerta Cani kërkon që edhe biznese të tjera të vendin të ndjekin këtë shembull, për t'u ardhur në ndihmë atyre që kanë nevojë për të dalë nga bota e "izolimit". Është shumë e vështirë të gjesh mbështetje në raste të tilla, sidomos në kushtet kur nevojat për personat me aftësi të kufizuara në vendin tonë janë shumë të mëdha. Shteti nuk ka statistika të mirëfillta, por nga studimet e herëpashershme të fondacionit është përcaktuar edhe tendenca në rritje të kërkesave për mjete lëvizëse. Megjithatë projekti i Vodafone Albania premtan të vazhdojë, duke u bërë një shkëndijë jo pak e vogël

Blerta Çani:

Më shumë biznese duhet të ndjekin shembullin e Vodafone Albania



Blerta Çani,
drejtoresha ekzekutive e
FSHDPK

shprese për këta njerëz. Në një intervistë zonja Blerta Çani tregon për nevojën e madhe të bashkëpunimit në këtë fushë edhe me biznese të tjera. Në mënyrë të veçantë, që në vitin e parë të aktivitetit, Vodafone Albania është fokusuar tek njerëzit me aftësi të kufizuara për të cilët mbështetja është gjithnjë e nevojshme dhe asnjëherë e mjaftë. “Kemi filluar këtë bashkëpunim me FSHDPAK e tashmë në një periudhë dy vjeçare kemi arritur të realizojmë 100 karrige. Por përveç kësaj, një numër i njerëzve të këtij komuniteti janë punësuar në punishten ‘Mirësia’, e cila është e specializuar për prodhimin e karrigeve me rrota. Jemi krenar që e quajmë veten nismëtar në lobin e biznesit që në mënyrë periodike financojmë projekte të tilla për këte komunitet”, sh-ton Z. Thomas Papaspyrou,



Drejtor i Përgjithshëm i Vodafone Albania. Ky projekt shkon në të gjitha skajet e Shqipërisë për të ndihmuar fëmijët, njerëzit e moshës së tretë në Tiranë, Durrës, Vlorë, Lezhë, Laç, Kukës, Gjirokastrë, etj - pra një gjeografi shpërndarjeje e gjerë. “Tek ne në Vodafone mbështetemi fort tek parimi i investimit social dhe përgjegjshmërisë së biznesit ndaj shoqërisë e mjedisit ku operojmë. Shoqëria zhvillohet si një e tërë, e ky zhvillim pret nga secili anëtar i shoqërisë, përfshirë dhe lobin e biznesit, që të kujdeset për këtë shtresë. Ne besojmë se kemi dhënë një kontribut që mund t’i shërbejë edhe të tjerëve për t’u bashkuar me ne, pasi së bashku do bëjmë edhe më shumë”, thotë Albi Greva, Vodafone.

Cili është qëllimi i bash-

këpunimit tuaj me Vodafone Albania?

Qëllimi i ceremonisë së dhjetorit ishte konkludimi i një projekti të mbështetur nga Vodafone Albania, nëpërmjet Vodafone Group Foundation i cili synonte në ofrimin e karrigeve me rrota për 30 persona me aftësi të kufizuara, në rrethe si Tirana, Durrësi, Berati, etj. Një përqindje e konsiderueshme e tyre ishin nga zonat rurale. Është hera e tretë që Vodafone mbështet prodhimin e mjeteve lëvizëse për njerëzit me aftësi të kufizuara në nevojë në të gjithë vendin dhe jo vetëm kaq, por nëpërmjet projekteve të tilla Vodafone mbështet edhe punësimin e njerëzve me aftësi të kufizuara që punojnë në punishten “Mirësia”, e cila prodhon pikërisht këto mjete lëvizëse. Është një nga komunitetet e biznesit që është regjurar më i vëmendshëm

dhe më aktiv në mbështetje të kategorive në nevojë në Shqipëri.

Dhe këtë e ka bërë në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, duke e çuar në 100 persona numrin e personave përfitues, për një periudhë 3-vjeçare. Vodafone Albania nuk ka nguruar të ofrojë ndihmë financiare që bën të mundur prodhimin e karrigeve me rrota për njerëzit me aftësi të kufizuara. Gjithashtu Vodafone ndihmoi



edhe në ofrimin e disa pajisjeve mjekësore për përdoruesit e karrigeve me rrota.

Sa janë kërkesat për karri-ge me rrota në vendin tonë?

Mbi 2300 ka qenë numri i përfituesve deri më sot, por duhet thënë se kërkesa ka shumë dhe janë në rritje, si nga zona rurale dhe urbane. Aktualisht ne nuk i plotësojmë dot të gjitha kërkesat dhe veprojmë në bazë të një listëpritjeje sipas të cilës përfiton ai që është më në nevojë dhe më në pamundësi për t'u pajisur në rrugë të tjera për t'u pajisur me një karrige me rrota, apo mjete të tjera lëvizëse.

Kemi bërë vlerësime për kërkesat e këtyre personave?

Nga një studim në disa rajone të vendit, janë 7 mijë persona me aftësi të kufizuara që kanë nevojë

Nese kompanise VODAFONE do ti shtoheshin dhe kontribute te tjera nga biznesi do te ishte me e lehte per te perballuar nevojat e medha te personave me aftesi te kufizuar per karrike me rrota.

për mjete lëvizëse në Shqipëri, për karrige me rrota, paterica dhe aksesore të tjerë që ndihmojnë lëvizjen dhe rehabilitimin e tyre. Shifra zyrtare nuk ka ende dhe ne veprojmë në bazë të sondazheve dhe vlerësimeve tona për nevojat.

Sa është jetëgjatësia e një karrigeje që prodhohet te punishte "Mirësia"?

Aktualisht ne prodhojmë karri-ge specifike që është ideuar për kushtet e Shqipërisë nga një organizatë e njohur në botë, që ofron asistencë teknike për vendet e botës së tretë e cila quhet "Motivimi" me qendër në Angli. Ajo ka jetëgjatësi 5 vjet, është shumë e fortë dhe materialet që përdoren janë shumë solide. Cikli i riciklimit është 5 vjet.

Gjatë gjithë aktivitetit të fondacionit FSHDPAK, si e

konsideroni bashkëpunimin me komunitetin e bizneseve në vend?

Është i pakët dhe jo të qëndrueshëm, thjesht sporadike në numra të vegjël dhe të paqëndrueshëm si bashkëpunime. Mendojnë se nese kompanise VODAFONE do ti shtoheshin dhe kontribute te tjera nga biznesi do te ishte me e lehte per te perballuar nevojat e medha te personave me aftesi te kufizuar per karrike me rrota.

A e shihni me optimizem vazhdimin e bashkëpunimit me VODAFONE?

Shpresoj qe ketij bashkepunimi te mire i pergjigjet nje sherbim kualitativ nga ana jone, duke krijuar kushtet qe donatori te kete kushtet dhe mundesite per te cuar edhe me tej kete partneritet në të ardhmen. Sic edhe permendem, shpresojmë që problemet e kësaj kategorie do të jenë në vëmendje edhe të komuniteteve të tjera të biznesit në Shqipëri, gjë që ndodh shumë rrallë.

**Brikena Demiras
Gazeta "Panorama"**

Ndryshimet e fundit ligjore në fushën e aftësisë të kufizuar

Me miratimin e ligjit **Nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”**, muajt e fundit sollën miratimin e njëserë vendimesh dhe udhëzimesh që plotësojnë këtë ligj, si dhe **ligjin nr.8626, date 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik plotësuar me vendim Nr. 619, datë 7.9.2006.** Nisur nga kërkesa e shumta të personave me aftësi të kufizuar, përfitues të programit ligjor pranë FSHDPAK, për tu njohur me ndryshimet e fundit në kuadrin ligjor të aftësisë së kufizuar po paraqesim më poshtë në mënyrë të përmbledhur risitë e fundit.

Ligji nr.8626, date 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” është plotësuar me **vendim Nr. 619, datë 7.9.2006.** Në bazë të këtij vendimi është shfuqizuar përcaktimi i mëparshëm në bazë të të cilit këtë status e përfitonin vetëm ata para apo tetraplegjikë të përcaktuar me diagnozë si të “dëmtuar në shtyllën kurrizore” ndërsa ndryshimi i ri ka dhënë përcaktimin e mëposhtëm pika I “I. Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) në rreth shqyrton të gjitha kërkesat e paraqitura nga personat e bërë paraplegjikë apo tetraplegjikë, *për shkaqe që lidhen me punësimin, të cilët përfitojnë nga ligji nr.8626, datë 22.6.2000.*” Si edhe vihet re, tashmë këtë status e përfitojnë të gjithë personat të cilët janë me diagnozën para apo tetraplegji, pavarësisht nga diagnoza, por përsëri ky rreth kufizohet duke e lidhur këtë gjendje me shkaqet që lidhen me punësimin, duke lënë ende të pa mbuluar atë kategori e cila nuk ka qënë ndonjëherë e punësuar por që has

njëserë vështirësish për shkak të para apo tetraplegjisë.

Ndryshime të rëndësishme sollën vendimet dhe udhëzimet e fundit të Ligjit **Nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”**, ku së pari u zgjerua rrethi i përfituesve nga ky ligj, konkretisht do të përfitojnë pagesën e aftësisë të kufizuar kategoritë;

1. Të verbërit, me mungesë të plotë ose të pjesshme të shikimit, të lindur ose të fituar, të cilët janë deklaruar të paaftë për punë, me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë (KMPV).

2. Paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët deklarohen, me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), se janë bërë të tillë pavarësisht nga shkak dhe moshë.

3. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

4. Personat, të cilët janë deklaruar **invalidë pune**, me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), përfitojnë një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit , sipas Statusit të Invalidit të Punës.

· Kategoritë e mësipërme përfitojnë edhe **kujdestar me pagesë** kur me vendim të komisioneve mjekësore të posaçme përcaktohen se kanë nevojë për kujdestar, duke u hequr kufizimi i mëparshëm që të përfitohej kujdestar me pagesë duhej në rradhë të parë që familja të ishte pjesë e skemës së ndihmës ekonomike.

Miratimi i vendimeve dhe udhëzimeve përcakton edhe kushtet dhe kriteret për përfitimin e ndihmës ekonomike. Duke qënë

se PAK janë në pjesën më të madhe të rasteve pjestarë të familjeve në nevojë dhe nga rastet e trajtuara në zyrë është shprehur interesi për njohjen e kësaj pjese të legjislacionit, shpjegimet e mëposhte mendojmë se do të jenë në interes të tyre.

Sipas VKM nr.787 datë 14.12.2005, ndihmën ekonomike e përfitojnë personat me aftësi të kufizuar që janë përfitues të pagesës së aftësisë të kufizuar apo pensioneve të invaliditetit (bazuar në status) të cilët mund të jenë kryefamiljarë apo anëtarë të familjeve në nevojë, të ardhurat materiale ose dhe monetare të tyre, janë të pamjaftueshme, nga veprimtaria ekonomike. Në të ardhura të familjes *nuk përfshihen në të ardhurat e familjes pagesat që marrin pjesëtarët e familjes me aftësi të kufizuar mendore, fizike, të verbërit, paraplegjikët e tetraplegjikët, përfitimet e invalidëve sipas Statusit të Invalidit të Punës, si dhe pagesat për fëmijët e lindur si trinjakë a më shumë.*

Dokumentat dhe kriteret për përfitimin e ndihmës ekonomike

Për përfitimin e ndihmës ekonomike kryetari i familjes, duhet të paraqes, pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në bashki/komune, këto dokumenta;

- Deklaratën për gjendjen social-ekonomike të familjes (model i cili gjendet pranë komunave apo Bashkive/ Njërive bashki-ake, sipas modelit të përcaktuar)
- Deklaratën tip mujore që plotësohet detyrimisht çdo muaj dhe firmoset nga të gjithë personat madhorë të familjes

që aplikon për ndihmë ekonomike.

- Çertifikatën e gjendjes familjare,
- Çertifikatën e pronësisë, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
- Aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës (tapinë e tokës) për zonat, ku regjistrimi i pronësisë nuk ka përfunduar ende.
- Vërtetimin si punëkërkuar të papunë, për të gjithë anëtarët e familjes, të aftë për punë, që aplikojnë për ndihmë ekonomike. Ky vërtetim lëshohet nga zyra e punës çdo tre muaj.
- **Për ato familje që kanë vendbanimin në qytet dhe që janë të regjistruara në zyrat e gjendjes civile të qytetit pas datës 1 gusht 1991, por që vendbanimin e tyre të mëparshëm e kanë patur në fshat, duhet të paraqesin, për të kërkuar ndihmë ekono-**

mike përveç dokumentave të mësipërme dhe këto dokumenta:

- Vërtetimin e nënshkruar dhe të vulosur nga kryetari i komunes a bashkisë (që në përbërje kanë fshatrat, banorët e të cilave janë trajtuar me tokë), nga kryetari i fshatit dhe përgjegjësi i zyrës së kadastrës, ku të thuhet se këto familje nuk disponojnë tokë në pronësi, sipas vendimit të komisionit të ndarjes së tokës, meqenëse janë larguar nga vendbanimi, para datës 1 gusht 1991, për arsye pune.
- Kopjet e librezës së punës, të noterizuara, që vërtetojnë se pjesëtarë të tyre kanë qenë të punësuar nga çasti i largimit nga vendbanimi në fshat.
- Çertifikatën e pronësisë së tokës, kur kanë përfituar tokë.
- Familjet e invalidëve të

punës, përveç dokumentave të përcaktuara më sipër duhet të paraqesin edhe kopjen e noterizuar të vërtetimit KMCAPI-t.

5. Familjet e invalidëve të punës, përveç dokumentave të përcaktuara më sipër duhet të paraqesin edhe kopjen e noterizuar të vërtetimit KMCAPI-t.

Masa e ndihmës ekonomike varion nga 2600 leke deri në 7000 lek, në varësi të përbërjes familjare të familjes në nevojë.

Kur aplikuesit i refuzohet kërkesa për përfitim të ndihmës ekonomike, pagesë për aftësinë e kufizuar ose të shërbimit shoqëror me vendim të këshillit të njësisë së pushtetit vendor, kanë të drejtë për apelim në gjykatë brenda 1 muaji nga momenti i marrjes dijani mbi këtë vendim.

**Entila Zyba, avokate
Koordinatorë e Programit
Ligjor pranë FSHPAK**

Debat Qytetar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar



Me mbështetjen e Komitetit Suedez të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në kuader të projektit “Asistencë dhe Avokati Ligjor për Personat me Aftësi të Kufizuar”, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në muajt tetor, nëntor, dhjetor 2006, organizoi

Debatet u zhvilluan në televizionet lokale; TV Teuta (Durrës), ETV (Elbasan) dhe TV Rozafa (Shkoder).

në rajonet, Elbasan Shkoder dhe Durrës tre debate me temë “Debat Qytetar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar”.

Keto debate të hapura, ndërmjet shumë aktoreve aktive, përgjegjëse për çështje të aftësisë së kufizuar si dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile të aftësisë së kufizuar, individëve me aftësi të kufizuar, familjareve të tyre kishin si qëllim të evidentonin problematiken e aftësisë së kufizuar në

rajonet perkatese si dhe të nxinin strukturat përgjegjëse për përmirësim dhe zgjidhje të tyre.

FSHPAK ka në themel të aktivitetit të tij promovimin e shanseve të barabarta dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me fokus të drejtat e njerezve me aftësi të kufizuara, me synim përmirësimin e cilesisë së jetës për ta dhe familjarët e tyre.

Ndaj dhe keto debate janë në vazhdimësi të fushatave të avokatise mbarekombetare që

ky fondacion organizon ne mbrojtje dhe respektim te te drejtave te personave me aftesi te kufizuar.

Fondacioni Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar eshte iniciues i hartimit te Strategjise Kombetare te Aftesise se Kufizuar si dhe shume nismave ligjore per mbrojtje dhe respektim te te drejtave te personave me aftesi te kufizuar ne Shqiperi. Pare nga ky kendveshtrim debatet u fokusuan ne ate se si strukturat pergjegjese lokale, shoqeria civile, individe marrin persiper dhe kontribuojne per te permiresuar cilesine e jetes se per-

sonat me Aftesi te Kufizuara ne nivel lokal; niveli dhe alternativat e sherbimeve sociale ne ndihme te personave me aftesi te kufizuar; përshtatshmëria ndërtimore për personat me aftësi të kufizuar në zbatim të normave urbanistike dhe arkitektonike për PAK; integrimi i femijeve me aftesi te kufizuar ne shkollat e zakonshme, zbatimimi i legjislacionit ne fushen e aftesise se kufizuar dhe problematikat ligjore ne funksion te tij ne rajonet perkatese dhe roli i rendesiseshem i FSHDPAK ne ofrimin e asistences ligjore falas ne keto rajone; kontributi i shoqerise civile per ofrimin



sonave me aftesi te kufizuar ne rajonet Elbasan, Shkoder, Durres.

Duke qene se prej shume vitesh Fondacioni Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar bashkepunon ngushtesisht me median si ne drejtim te informacionit ashtu edhe te trainimeve per gazetaret e mediave lokale, keto debate u moderuan nga gazetarë profesioniste te perfshire ne keto trainime.

Pjese te debateve u bene qeshtje te tilla si: Zbatimi i Strategjise Kombetare per Per-

e modeleve te sherbimeve ne mbrojtje dhe respektim te te drejtave te personave me aftesi te kufizuar.

Debatet u zhvilluan ne tv lokale; TV Teuta (Durres), ETV (Elbasan) dhe TV Rozafa (Shkoder). Keto debate kane rezultuar te ndjekura dhe me interes nga publiku, fakt qe e deshmojne telefonatat dhe vizitat te klienteve ne qendrat e FSHDPAK ne keto rajone.

Narbis Ballhysa
Koordinatorë Pro-
grami prane FSHDPAK

Qendra per Zhvillimin e Shanseve te Barabarta

S iç eshte bere tashme e ditur, ne qytetin e Shkodres prej nje viti, Qendra Per Zhvillimin e Shanseve te Barabarta, ka çelur dyert e saj dhe ofron sherbime per personat me aftesi te kufizuara, duke patur si objektiv primar, promovimin e shanseve te barabarta dhe mbrojtjen ligjore, me synim permiresimin e jetes per ta dhe familjaret e tyre.

Qendra e Zhvillimit te Shanseve te Barabarta, eshte projekti me iri i Fondacionit Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar.

Duke patur parasysh qe organizata te ndryshme lokale veprojne prej vitesh ne qytetin e Shkodres ne fushen e aftesise se kufizuar, eshte per t'u nenvizuar fakti qe FSHDPAK, ofron nje alternative konkrete permes promovimit te kesaj qendre ku eshte e rendesishme te theksohet qe aktiviteti i saj perqendrohet kryesisht ne mbeshtetjen e PAK si dhe promovon te drejtat dhe formimin e tyre permes arsimit, punesimit, jetes aktive ne komunitet.

Nepermjet ndergjegjesimit te strukturave shteterore, opinionion publik dhe perfshirjes se aktoreve te tjere te shoqerise civile si media, organizata lokale, kombetare e nderkombetare, Qendra e Zhvillimit te Shanseve te Barabarta, synon mbrojtjen e interesave me te larta te aftesise se kufizuar dhe ofrimin e nje sherbimi sa me cilesor.

Duke patur parasysh qe qendra gjithashtu, sherben si nje qend-

Vijon në fq.14

er burimore eshte e natyrshme te kuptohet frekuentimi i saj i vazhdueshem, i cili pasqyrohet mjaft mire permes aktivitetit didor, mbeshtetjes juridike dhe sociale, literatures perkatese ne ndihme te personave te interesuar, etj. Personat te cilet kane kerkuar ndihme prane kesaj qendre kane paraqitur nevoja te ndry-

simore, Dhomes se Tregtise dhe Zyrave te Punesimit.

Per t'u nenvizuar jane takimet dhe negocitat me Bashkine e cila ka qene nje nder institucionet te cilat kane dhene nje kontribut mjaft domethenes ne realizimin e ketij projekti. Nder te tjera ne keto takime eshte diskutuar kryesisht ne lidhjen e ne-

uale. Target grupi perbehej kryesisht nga mesues, drejtues dhe inspektore te cilet veprojne ne fushen e aftesise se kufizuar. Te tille ishin perfaqesuesit e shkollave "Ndre Mjeda", "Mati Logoreci" te cilat perbejne dhe shkollat pilot te perfshira ne kete program, Shkolla speciale "3 Dhjetori", dhe kopshtet "Ismet Sali



Qendra per Zhvillimin e Shanseve te Barabarta,

nje alternative sherbimesh per problematiken e aftesise se kufizuar ne Rajonin e Shkodres

shme si ne, aspektet e ndihmes ekonomike, kujdestarise, pensionit te invaliditetit, strehimit duke marre gjithashtu asistencen e kerkuar. Nje vemendje e veçante gjate kesaj periudhe i eshte kushtuar dhe fushates ne nivel lokal per gjithperfshirjen e personave me aftesi te kufizuar ne jeten e perditshme dhe te mbrojtjes se te drejtave te tyre.

Qe nga dita e çeljes, kjo qender ka zhvilluar nje aktivitet mjaft te gjere, i cili eshte pasqyruar gjithashtu permes takimeve dhe trajnimeve te cilat kane kontribuar ne krijimin e urave te bashkepunimit mes Qendres se Zhvillimit te Shanseve te Barabarta dhe enteve te ndryshme lokale dhe publike. Shume nga keto takime jane zhvilluar me perfaqesues te Bashkise, Drejtorise Ar-

gocitave per te siguruar mireqenien, arsimimin dhe punesimin e personave me aftesi te kufizuara, si dhe mbeshtetjen e tyre ekonomike. Gjithashtu trajnimi i disa perfaqesuesve te ketij stafi, me qellim permiresimin e sherbimeve ne mbeshtetje te personave me aftesi te kufizuara eshte nje nder pikat kryesore te ketij bashkepunimi.

Ne kuadrin e integritimit te femijeve me aftesi te kufizuara ne arsim gjithperfshires, eshte realizuar nje numer i konsiderueshem takimesh me Drejtorine Arsimore, ku nder te tjera jane realizuar trajnime me perfaqesues te drejtorise arsimore, drejtorive te shkollave ku jane te integruar femije me AK dhe mesuesve te cilet punojne me to, duke u bazuar ne modele individ-

Brucej" dhe "Bep Tusha" si dhe institucione te tjera arsimore te fokusuar ne sferen perkatese. Temat kryesore qe u zhvilluan ne keto trajnime kane qene kryesisht: Njohja me vesh-tiresite specifike ne te mesuar, Role dhe funksione ne procesin e integritimit si: roli i prindit, mesuesit, punojesit social, etj.

Eshte per t'u nenvizuar fakti qe nje pune mjaft e mire eshte bere per integrimin e femijeve AK ne arsim. Aktualisht dhjete femije jane integruar tashme ne klasat e para dhe nje numer i konsiderueshem jane nen veshgim.

Integrimi i PAK ne pune dhe formimi i tyre profesional perben nje nder prioritetet e FSHDPAK. Nepermjet takimeve me Dhomen e Tregtise dhe Qendrat e Biznesit ne Shkoder eshte

diskutuar mbi mundesine e kualifikimit dhe punesimit te personave me aftesi te kufizuara ne ambiente gjithperfshirese. Duke patur parasysh veshtiresite qe karakterizojne punesimin e PAK, kryesisht diskutimet jane perqendruar ne problemet e integritimit, ndergjegjesimin e opinionit publik, zhveshjen nga paragjykimet, menytrat se si punedhenesi duhet te sillet me PAK per te lehtesuar dhe favorizuar integrimin etj.

Mbeshtetja per krijimin e nje rrjeti te prinderve te femijeve me aftesi te kufizuar si dhe mbeshetja e rrjetit ne fushatat per lobim dhe avokati per te drejtat e femijeve te tyre perben nje nder pikat kyçe ne veprimtarine e FSHDPAK ne Shkoder. Takimet me grupin e prinderve, te cilet jane zhvilluar prane kesaj qendre kane qene kryesisht te perqendruara ne planin e integritimit te PAK, ne jeten sociale, arsim dhe pune si dhe gjithashtu eshte diskutuar mbi menytrat e zgjerimit te rrjetit dhe te bashkepunimit ne nivel lokal me institucionet perkatese dhe median. Gjate ketyre takimeve eshte mundesuar nje pjesemarrje e gjere ku ky grup perbehej kryesisht nga familjare dhe te aferm te PAK. Anetaret e ketij rrjeti jane trajnuar nga FSHDPAK gjithashtu mbi te drejtat dhe aftesine e kufizuar, rendesine e perftimit te sherbimeve sociale, ndergjegjesimi per vlerat, normat dhe qendrimet ne lidhje me çeshtjet e PAK, etj.

Gjate kesaj periudhe nje vemendje jo e vogel i eshte kushtuar medias, si nje mjet i rendesishem ne pasqyrimin e aktivitetit te qendres i cili eshte reflektuar kryesisht, permes televizioneve lokale, gazetes dhe radios se qytetit. Kontaktet e vazhdueshme



Seminari u karakterizua nga nje pjesemarrje e gjere, ku te ftuarit ishin perfaqesues nga pushteti lokal dhe shoqeria civile te cilet treguan nje interes te gjere ndaj ketij aktiviteti, ne menyre te veçante ndaj literatures se gjere qe FSHDPAK, kishte vene ne dispozicion te tyre.

me median si dhe paisja me materiale te ndryshme, literature e fondacionit, kane qene elemente baze per monitorimin e saj si dhe reflektimin e problemeve te aftesise se kufizuar ne menyre pozitive. Nepermjet medias, mjaft gjeresisht, u pasqyrua dhe takimi prezantues “Qendra e Shanseve te Barabarta”, projekt i FSHDPAK. Seminari u karakterizua nga nje pjesemarrje e gjere, ku te ftuarit ishin perfaqesues nga pushteti lokal dhe shoqeria civile te cilet treguan nje interes te gjere ndaj ketij aktiviteti, ne menyre te veçante ndaj literatures se gjere qe FSHDPAK, kishte vene ne dispozicion te tyre.

Qellimi i ketij takimi ishte pikërisht dhe prezantimi i Qendres se Shanseve te Barabarta si dhe, lidhja e kontakteve dhe urave te

bashkepunimit me institucione te pushtetit lokal, shoqerise civile dhe medias. Nder te ftuarit ishin Perfaqesues nga Bashkia, Prefektura, Zyra Rajonale dhe Zyra e Punes, Drejtoria Arsimore dhe Perfaqesues te Shkolles Speciale. Persa i perket perfaqesuesve nga Shoqeria Civile, te ftuar ishin OJF si: OSBE, CSDC, Casa Famiglia, Hapat e Lehte, Gruaja tek Gruaja, The Door etj. Aktiviteti u pasqyrua gjeresisht nga Media Lokale, TV Rozafa, TV Shkodra Institucioni i Radios dhe Zeri i Amerikes.

Aktiviteti me i rendesishem

ne bashkepunim me median ka qene dhe realizimi i nje tryeze te rumbullaket titulluar “ Debat Qytetar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar” realizuar ne bashkepunim me TV Rozafa, ne te cilin moren pjese aktore, perfaqesues te fondacionit, pushtetit lokal, shoqerise civile, prinder, femije me aftesi te kufizuar si dhe studente te fakulteteve te juridikut dhe psikologjise. Debatu u zhvillua prane Kinema Millenium, ne formen e nje bashkebesedimi mes aktoreve ne panel dhe publikut te larmishen ne salle ku te pranishmit ndane opinionet e tyre me njeri-tjetrin si dhe parashtruan alternativa ne fushen perkatese.

Koncerti artistik “Me kenge jetes i flas” qe nje nder veprimtarite e cila mbylli aktivitetin vjetor te fondacionit. Ky aktivitet u zhvillua ne bashkepunim me Qendren Kulturore per Femije, Shkoder ku te pranishem ishin perfaqesues te arsimit, Shkolles Speciale, medias dhe prinder e femije me aftesi te kufizuar. Gjate aktivitetit, femijet me aftesi te kufizuara, kenduan, recituan se bashku me femijet e Qendres Kulturore dhe ne fund per te pranishmit u shperndane dhurata.

Gjithashtu, pjesemarrja e qendres ne aktivitete te ndryshme sociale te qytetit dhe ne shkalle kombetare ka qene mjaft me vlere per aktivitetin ne pergjithesi si dhe vlen per t’u theksuar qe angazhimet e ndryshme ne mbeshtetje te ketij projekti, jane per me shume shanse ne jete per personat me aftesi te kufizuar.

Edlira Grabova

*As/Koordinatorë projekti,
Shkoder*

Gjithpërfshirja

Në kuadrin e procesit të reformimit ligjor e institucional të planifikimit dhe monitorimit hapësinor në Shqipëri, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ndërmori nismën për hartimin e një ligji të ri “Për Planifikimin Hapësinor”. Për këtë qëllim, nën drejtimin dhe organizimin e Drejtorisë së Politikave të Planifikimit Urban dhe me mbështetjen e USAID-it, LGDA dhe GTZ u organizuan një seri diskutimesh dhe konsultimesh me të gjitha grupet e interesit me synim hartimin e një dokumenti politikash për hartimin dhe zbatimin më tej të një kuadri të ri ligjor të planifikimit hapësinor në Shqipëri.

Me ftesë të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, unë mora pjesë në këto diskutime jo thjesht si inxhinjere, por si përfaqësuese e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, një organizatë që mbron të drejtat e një prej grupeve më të ndjeshme dhe më të interesuara, që përben më shumë se 14% të popullsisë. Kjo nuk ishte e rastësishme. Përpyekjet disa vjeçare ndërgjegjësuere të FSHD-PAK për të tërhequr vëmendjen e institucioneve për rendësinë, domosdoshmërinë dhe detyrimin për të ndërtuar një mjedis të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuar, çuan në kuptimin dhe vlerësimin e domosdoshmërisë së përfshirjes edhe të këtij grupimi në diskutime për hartimin e një ligji bashkëkohor, gjithpërfshirës.

Në fund të procesit disa mujor u finalizua një draft doku-

ment politikash që mbështetej tërësisht në dokumenta ndërkombëtare dhe europiane dhe që përcaktoi objektivat e sistemit të planifikimit hapësinor në Shqipëri drejt hartimit të ligjit “Për Planifikimin Hapësinor në Shqipëri”

Në fund të të gjitha këtyre zhvillimeve natyrshëm lind pyetja



: A do të ketë vërtet ligji i ri një nivel bashkëkohor gjithpërfshirës?

Le t’i rikthehemi edhe një herë zhvillimit të procesit.

Objektivat e këtij draft dokumenti janë të tilla që synojnë në drejtim të përfaqësues së integruar gjithpërfshirëse që kalon tej urbanizimit dhe menaxhimit të tokës, duke marrë parasysh çështje dhe objektiva sociale, ekonomike dhe mjedisore. Kjo do të thotë që krahas koordinimit sistematik vertikal ndërmjet niveleve të qeverisjes, të përfshijë edhe atë horizontal ndërmjet të gjithë aktorëve të interesit në qeverisje, biznes dhe në shoqëri në tërësi. Kjo mundësoi përfshirjen e grupimit të aftësisë së kufizuar në këtë fazë të rendësishme diskutimesh, krahas shumë përfaqësuesve të grupeve të ndryshme të interesit, duke

përtej një ligji



Ofrimi i informacionit të bollshëm dhe eksperiencave ndërkombëtare nga ekspertet e huaj; forumet më të gjera të organizuara në tryezë dhe nëpërmjet internetit nga organizatorët e kësaj nisme për të tërhequr ide të një rrjeti më të gjerë të interesuarish, ishin hapa të mëtejshëm drejt gjithpërfshirjes.

ndërtuar kështu një model tejet gjithpërfshirës hartimi politikash.

Ekspertë dhe specialistë, si përfaqësues të institucioneve të ndryshme të nivelit qendror dhe lokal, si përfaqësues të niveleve të ndryshme njohurish dhe përvojash, të orientimeve të ndryshme politike, të ulur në këtë tryezë paraqisnin ide dhe diskutonin me profesionalizëm dhe përgjegjshmëri për të hartuar këtë kornizë gjithpërfshirëse politikash, me syn-

imin e vetëm që ky draft politikash të ishte sa më orientues drejt hartimit të një ligji planifikimi hapësinor bashkëkohor.

Aty ndërthureshin orientimet e një drejtuesi ministrie; eksperiencia e pasur e një instituti; shqetësimet e njësitëve të pushtetit vendor dhe të specialistëve biznesmenë të ndërtimit; shqetësimet dhe kërkesat e grupimeve të veçanta si ato të personave me aftësi të kufizuar, shoqatave të pronarëve, të ambientalistëve; ekspertiza juridike e përfaqësuesve të ministrive përkatëse dhe e bashkisë Tiranë, që lehtësonin dhe orientonin shpesh konkluzionet – të gjitha të konvertuara në nivel specialistësh - një model përtej gjithpërfshirjes së një dokumenti politikash.

Ofrimi i informacionit të bollshëm dhe eksperiencave ndërkombëtare nga ekspertet e huaj; forumet më të gjera të organizuara në tryezë dhe nëpërmjet

internetit nga organizatorët e kësaj nisme për të tërhequr ide të një rrjeti më të gjerë të interesuarish, ishin hapa të mëtejshëm drejt gjithpërfshirjes.

Përzgjedhja për zhvillim e takimeve e Hotel Tirana International, një objekt nga të paktit të përshtatur në Tiranë përsa i përket infrastruktures dhe shërbimeve; shoqërimi dhe asistenca që më ofrohej mua si përdoruese e karriges me rrota nga të gjithë pjesëmarrësit e këtij aktiviteti, pa dalluar nëse ishte i njohur apo i panjohur, drejtues apo specialist i thjeshtë; vlerësimi dhe pranimi i kërkesës që paraqita që në këtë kornizë politikash të përfshihej koncepti i plotë i përshtatshmërisë mjedisore për aftësinë e kufizuar - shkojnë edhe më tej gjithpërfshirjes së një ligji.

Lenia hapur e procesit të rekomandimeve për përmirësime edhe pas konferencës prezantuese të draftit flet përsëri për gjithpërfshirje.

Tashmë hartimi i ligjit është në proces. Me të po merren së bashku ekspertë dhe specialistë ligjorë vendas dhe të huaj. A do të ketë ligji që do të mbështetet në këtë dokument politikash nivel bashkëkohor gjithpërfshirës? Proçesi tejet gjithpërfshirës që shoqëroi të gjithë fazën e hartimit të dokumentit të politikave duhet të vijojë si i tillë edhe më tej, gjatë hartimit të ligjit, dhe vetëm nëse do t'i lejojmë specialistët të punojnë si specialistë dhe t'i mbështesim me rekomandime profesionale, ky ligj do të arrijë të hartohet që të jetë tërësisht i zbatueshëm për një planifikim hapësinor gjithpërfshirës në Shqipëri.

Bardhylka Kospiri
Koordinatorë e Programit të Avokatise pranë FSHDPAK

Sherbime ne komunitet per personat me aftesi te kufizuar dhe familjaret e tyre



Nga data 4- 7 dhjetor 2006 ne Washington te Shteteve te Bashkuara te Amerikes u organizua Kongresi i 9-te Nderkombetar per Sherbimet komunitare dhe kujdesin shendetesor per femijet , te rinjte me aftesi te kufizuar dhe familjet e tyre.

Tema e Kongresit te 9-te eshte: "Sherbime ne komunitet per çdo njeri" Margaret Khanini (drejtore ne zyren e paaftesise ne Departamentin per Shendetin dhe Sherbimet Shoqerore te Shteteve te Bashkuara) ne pershendetjen e saj ne hapje te punimeve te ketij Kongresi tha se temen ky kongres e ka :*Te eksploroje komponentet me kryesore te iniciatives se re per lirine,nga Xhorxh W Bush , nje initiative shume e perhapur per eliminimn e barrierave qe ndalojne njerezit me aftesi te kufizuar te marrin pjese ne menyren me te plote ne gjithë jeten shoqerore. Ajo permban tema qe perfshijne njerezit me aftesi te kufizuar ne te gjitha vendet ne fusha si shendeti, edukimi, trajnimeve te ndryshme ,transportin, punesimin, strehimin, teknologjien dhe gjithëperفشirjen.*

Qe ne Kongresin e l-re te organizuar ne Qershor te vitit 1992 ne ndihmesen qe Shtetet e Bashkuara kane dhene per vendet te Europes Lindore eshte vene thek-

si te zhvillojne perkujdesjen me ne qender familjen. Keto pervoja kane ardhur ne rritje dhe ne kete Kongres te 9-tin pati pervoja shume pozitive qe u dhane nga keto vende.

Ne Kongres merrnin pjese grupe nga 61 vende te botes. Nga vendi yne moren pjese specialistet Anastas Suli dhe Ariel Çomo, perfaqesuese e FSHDPAK Florida Kalemi, i riu me aftesi te kufizuar Doris Koka dhe perfaqesuese e prinderve nga shoqata MEDPAK, Zela Koka.

Grupi jone i ndoqi me vemendje te madhe punimet e ketij Kongresi si dhe u njoh me pervojen e shume vendeve ne punen qe behet me dhe per grupin e njerezve me aftesi te kufizuar ne drejtim te aftesimit, punesimit, edukimit dhe eliminimit te barrierave per nje pjesemarrje sa me te gjere te personave me aftesi te kufizuar ne jeten e komunitetit.

Nga disa vende erdhen pervoja ne punen qe po behet per arsimimin e femijeve me aftesi te kufizuar duke u bazuar ne zhvillimin e arsimit gjithëperفشires. Duke punuar per arsimimin e femijeve me aftesi te kufizuar ne shkolla gjithëperفشires perfitimet jane per te gjithë, per femijet me aftesi te kufizuar, familjet e tyre, per komunitetin e shkollave ku keta femije edukohen dhe per qeverite lokale dhe qendrore, pasi femijet e tjere pergatiten per nje bote me shume ngjyra dhe shpenz-

imet jane me te vogla se ne shkollat e veçanta apo qendrat rezidenciale.

Zeri i te rinjve me aftesi te kufizuar, ne kete Kongres ishte diçka e pazakonte per ne dhe shume mbreselene. Ata diskutuan ne lidhje me nevojat e tyre dhe si do t'i realizonin ato ne vendet e tyre duke ndryshuar politikat dhe krijimin e kulturave te reja per perfshirjen e tyre ne edukim, punesim dhe gjithë jeten e komunitetit.

Fuqizimi i familjeve nepermjet vleresimit te nevojave dhe dhënien e sherbimeve me baze ne



komunitet ishte nje pervoje e shkelqyer e shoqates Zeri i Familjes ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes.Pra per veç vleresimit

te nevojave per personin me aftesi te kufizuar duhen vleresuar edhe nevojat e familjes se ketij personi .

Perveç punes ne seanca kryesore dhe diskutimeve ne grupe , organizuesit e Kongresit kishin planifikuar edhe aktivitete praktike si vizita ne shkollë gjithëperفشires, ne spitale dhe ne ambiente publike (metro) per te pare gjithë ndryshimet qe jane bere nga qeveria Ameriakne per te krijuar akses per pavaresine ne levizje te personave me aftesi te kufizuar.

Duke pare pervojat e dhena ne kete Kongres , zhvillimet ne vende te ndryshme dhe idete qe dolen nga ky Kongres per permiresimimn e jeteses se personave me aftesi te kufizuar duke dhene sherbime ne komunitet

mendoj qe edhe ne Shqiperi me gjithë punen e bere deri tani duhet te punojme me programe ne drejtim te :

1. Fuqizimit te familjeve te personave me aftesi te kufizuar, duke shkuar drejt sherbimeve me baze komunitare.

2. Ngritjen e qendrave te vleresimit per aftesine e kufizuar qe ne femijerine hereshme me

ekipe multidisiplinare me qellim dhenien e sherbimeve sipas nevojeve qe ka individi per gjithepershirjen e tij ne jeten e komunitetit.

3. Ngritjen e qendrave te specializuara per dhenien e sherbimeve per femijet autiste(deri tani ne Shqiperi nuk ka asnje te tille) si dhe sherbime ndaj personave me aftesi te kufizuar ne gjendje vecanerisht teper te renduar.

4. Formimit te lidereve ne grupin e te rinjve me aftesi te kufizuar, me qellim qe vete ata te jene vendimmarres per problemet e tyre per krijimin e nje jetese te pavarur ne komunitet.

5. Advokatise e lobimit per permiresimin e legjislacionit bazuar ne standartet e vendeve me te perparuara.

Zela Koka
Shoqata MEDPAK

Të drejta dhe dinjitet të barabartë për personat me aftësi të kufizuar

Institucioni i Avokatit te Popullit në bashkëpunim me “Save the children, Albania” “Unicef”, “Këshillin Kombëtar të Aftësisë të Kufizuar” dhe “Fondacionin Shqipëtar për të Drejtat e PAK” organizoi në datë 11.12.2006 Konferencën Kombëtare me temë “Të drejta dhe dinjitet të barabartë për personat me aftësi të kufizuar”. Pjesë e konferencës ishin jo vetëm shoqatat dhe qendrat, që veprojnë në mbrojtje dhe promovim të të drejtave të PAK, si në nivel kombëtar dhe lokal, por edhe perfaqesues te larte te institucioneve qendrore pergjegjes per hartim dhe zbatim te polikave dhe legjislacionit ne fushen e aftesise se kufizuar.

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar luajti një rol të rëndësishëm në organizimin e kësaj konferencë në bashkëpunim me institucionin e Avokatit te Popullit. Ofrimi i materialeve burimore lidhur me mbrojtjen dhe provomin e të drejtave të personave me aftesi



Konferenca ndikoi pozitivisht, duke i sjellë edhe njëherë në vëmendje Qeverisë Shqipëtare detyrimet ligjore që janë sanksionuar nga legjislacioni shqiptar dhe nga konventat e ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë në fushën e aftësisë të kufizuar

te kufizuar si dhe prezantimet ne kete konference nga Drejtori Ekzekutiv i FSHDPAK Zj. Blerita Çani dhe Koordinatorës të Programit të Avokatisë pranë FSHDPAK, zj. Bardhylka Kopsiri me temë “Legjislacioni, si zbatohet, mangesitë dhe

problematikat e aftësisë të kufizuar ne Shqiperi” ishin shprehje te ketij bashkepunimi. Konferenca ndikoi pozitivisht, duke i sjellë edhe njëherë në vëmendje Qeverisë Shqipëtare detyrimet ligjore që janë sanksionuar nga legjislacioni shqiptar dhe nga konventat e ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë në fushën e aftësisë të kufizuar, me qellim garantimin e te drejtave te personave me aftesi te kufizuar.

SI TË GATUAJMË

SPINAQ I SKUQUR

Normativa për 5 persona :

Spinaq	1.5 kg
Vaj ulliri	dy filxhan kafeje
Hudher	1 koker
Limona të shtrydhur	dy kokra
kripë e piper	

Përgatitja : Hedhim spinaqin në një tenxhere me ujë të bollshem të vluar me kripë ku zjen për 5 minuta. E kullojme, e presim në copa të vogla dhe e skuqim.

Në një tigan me vaj ulliri skuqim hudhrat e grira deri sa të zverdhen, shtojmë spinaqin, i për ziejme, hedhim kripë, piper e leng limoni.

Shoqërohet me qofte të fërguara, biftek të furrës e mish të pjekur.

TASQEBAP

Normativa për 5 persona :

Mish tul 500 gr,
Vaj 150 gr,
Qepë të thata
3 kokra mesatare,
Salcë domate
1 lugë gjelle,
Miell 1 lugë gjelle,
Hudhra 2 kokra,
Pak verë të bardhe,
Dafinë 1 gjethe,
Kripë, piper e rigon.

Përgatitja :

Skuqim në tenxhere mishin e prerë në kubike të vegjel sebashku me qepën. Shtojmë kripë, piper, hudhra, dafinë dhe i për ziejme pa i hequr nga zjarri sa të zbuten. Shtojmë salcën e vazhdojmë skuqjen për rreth 5 minuta duke shtuar miell. E shuajmë me verë për 2 minuta duke e zjere me kapak të mbyllur. Shtojmë ujë të nxehte sa të mbulohet mishi dhe e lëmë në zjarr të avashem për 30 minuta. Shërbehet i nxehte.

HALLVE ME MIELL GRURI

Normativa për 5 persona :

Miell 200 gr,
Sheqer 200 gr,
Vaj 2 filxhan kafeje
Pak kanëlle.

Përgatitja : Skuqim miellin e situar në një tenxhere me fund sferik në vaj të nxehte der sa të mare një ngjyre geshtenje të çelet. Sherbetin e për gatitur dhe aromatizuar me kanëlle e shtojmë gradualisht duke e punuar me lugë druri sa të thithet gjithë sasia e ujit dhe masa e për ftuar të shkeputet nga ena.

Lihet të ftohet pak dhe hidhet në forma.

Gjate përdorimit kthehet në pjate dhe pudroset me sheqer e kanëlle.

PESHK ME ARRA

Normativa për 5 persona : Peshk 1 kg, Arra të qeruara 100 gr, Vaj 2 filxhan kafeje, Miell 2 lugë gjelle, Vere e kuqe 1 filxhan kafeje, Hudhra 5 thelpinj, Limon 1 koker, Kripë, piper e një gjethe dafinë.

Përgatitja : Skuqim peshkun e kriposur dhe e lëmë në një enë me kapak të mbyllur. Në vajin e mbetur hedhim hudhrat e grira, arrat e shtypura, miellin dhe i kaverdisim pak. E shuajmë me verë dhe e shtojmë me ½ litri ujë të nxehte, dafinë dhe e ziejme deri sa lengu të trashet pak. E shijojme me kripë e piper. Shërbehet e nxehte duke e shoqëruar me feta limoni.

**Josif Mio, Shef Kuzhine
Person me aftësi të kufizuar
në të shikuar, Berat**